



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:058237

Datë: 16.02.2024

Numri i dokumentit: 05339208

C.nr.1106/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditësve B. K. nga Prizreni dhe D. Sh. nga Podujeva, të cilat sipas autorizimit i përfaqëson avokate V. I. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontestit kompensim për avancim në karrierë dhe zhvillim profesional, jashtë seancës, me datë 15.02.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve B. K. nga Prizreni dhe D. Sh. nga Podujeva, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve t'ia paguaj shumat si në vijim:

-Paditëses së parë B. K. në emër të diferencës së papaguar në pagë bazë të licencimit - gradimit për periudhën nga data 18.04.2017 deri më 21.11.2022, t'ia paguaj 27% e pagës bazë (paga bazë është 421.20 €) e në total 67 muaj t'ia paguaj shumën prej 3,711.80€.

Paditëses së dytë D. Sh. në emër të diferencës së papaguar në pagë bazë të licencimit - gradimit për periudhën nga data 19.09.2018 deri më 21.11.2022, t'ia paguaj 27% e pagës bazë (paga bazë është 421.20 €) e në total 51 muaj t'ia paguaj shumën prej 2,825.40€.

Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë (28.03.2022) deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi, nën kërcënimin e pasojave ligjore - përmbarimit të dhunshëm.

II. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve përtej shumave të gjykuara si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi në emër të diferencës së papaguar në pagë bazë të licencimit - gradimit për periudhën nga data 22.11.2022 deri më 31.12.2023, gjithsej për 2 muaj dhe atë: për paditësen e parë B. K. në shumën prej 110.80€, dhe për paditësen e dytë D. Sh. në shumën prej 110.80€, si e pabazuar.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëseve në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguaj shumë prej 186.00€, në afat prej 7 ditësh nga marrjes së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditëset përmes të autorizuarës së tyre, me datë 28.03.2022 kanë paraqitur padi me objekt kontesti kompensimin e pagave mbi bazën e kualifikimit, e drejtë kjo e garantuar me Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.01/33 të datës 29.08.2008. Tutje ka theksuar se paditësit janë në marrëdhënie pune te e paditura në shkollën fillore të mesme të ultë “Qamil Batalli” në Prishtinës. Në precizimin e kërkesëpadisë, ka shtuar se paditëset janë kompensuar pjesërisht në emër të licencimit-kualifikimit, duke kërkuar që paditëses të parë B. K. në emër të diferencës së papaguar në pagë bazë të licencimit - gradimit për periudhën nga data 18.04.2017 deri më 31.01.2023, t’ia paguaj 27% e pagës pazë (paga bazë është 421.20 €) e në total 69 muaj t’ia paguaj shumën prej 3,822.60€, dhe paditëses së dytë D. Sh. në emër të diferencës së papaguar në pagë bazë të licencimit - gradimit për periudhën nga data 19.09.2018 deri më 31.01.2023, t’ia paguaj 27% e pagës pazë (paga bazë është 421.20 €) e në total 53 muaj t’ia paguaj shumën prej 2,936.20€, me kamatë ligjore 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, duke kërkuar nga gjykata që të aprovohet në tërësi kërkesëpadia si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, për arsye se një kompensim i tillë nuk është paraparë as me Ligjin e Punës nr.03/L-212. Tutje ka theksuar se e paditura gjatë përgatitjes së buxhetit nuk ka paraparë në skemën e saj buxhetore, linje të veçantë buxhetore për këto lloje të kompensimeve. Prandaj, ka kërkuar nga gjykata pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e provave të bashkangjitura padisë, si dhe pas pranimit të përgjigjes në padi, mbështetur në nenin 8 dhe 398 të LPK-së, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, por se e paditura ka ngritur çështje që kanë të bëjnë me pamundësinë e përmbushjes së detyrimit. Në këtë rast kontestues është vlerësuar se nuk ka pengesa në kuptim të dhënies së vendimit meritor jashtë seance.

Nga provat e bashkangjitura padisë gjykata gjeti se paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura, sipas kontratave të lëshuara nga e paditura dhe atë: paditësja e parë B. K. sipas kontratës me nr. prot.24/2015 të datës 10.03.2015, dhe paditësja e dytë D. Sh. sipas kontratave të datës 18.09.2018, 08.01.2019, 08.04.2019, 02.09.2019.

Bazueshmëria e kërkesëpadisë së paditësve ka mbështetje në Vendimin me numër nr.01/33, të datë 29.08.2008, nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ashtu që në pikën 3 të këtij Vendimi përcaktohet se “ngritja e pagave për mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në nivelin fillorë dhe atë të mesëm bëhet në bazë të kriterëve të licencimit, si: përgatitja profesionale (kualifikimi) dhe përvoja e punës”, ndërsa në pikë 4 thuhet

se mësimdhënësit, drejtoret (zëvendësdrejtoret) dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur me, pika 4.3 “me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagesës bazë prej 27%”, ndërsa në pikën 4.4 përcaktohet se “me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”.

Nga këto pretendime gjykata ka vlerësuar se baza juridike e kërkesëpadisë së paditësve bazohet në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008, respektivisht pika 4, nga i cili Vendim të paditurës i ka lindur detyrimi për kompensimin e kësaj difference në pagë të palëve paditëse, për më tepër vetë pala e paditur në mënyrë të heshtur e ka paguar pjesërisht këtë detyrim ndaj paditësve, në momentin që e njëjta i ka paguar për çdo muaj paditësve në emër të kualifikimit dhe atë: paditëses B. K. shumën prej 58.32 €, dhe paditëses D. Sh. shumën prej 58.32 €.

Ndërsa nga kontrata e punës dhe lista e pagave shihet se paditësja B. K. për periudhën 18.04.2017 e deri më 21.11.2022 në emër të kualifikimit me Bachelor, i takon lartësia prej 27%, të pagës bazë, ndërsa i është paguar shuma prej 58,32 €, e që në fakt është dashur të paguhet shuma prej 113,72 €, çka do të thotë se e paditura ka hyrë në detyrim tek paditësja për 67 muaj, apo zbërthyer në vlera monetare shuma prej 55.40 €, për muaj (paga 421.20 € x 27% = 113.72 €, minus 58.32 €, përfitohet shuma prej 55.40€, x 67 muaj arrihet shuma prej 3,711.80€), dhe paditëses D. Sh. për periudhën 19.09.2018 e deri më 21.11.2022 në emër të kualifikimit me Bachelor, i takon lartësia prej 27%, të pagës bazë, ndërsa i është paguar shuma prej 58,32 €, e që në fakt është dashur të paguhet shuma prej 113,72 €, çka do të thotë se e paditura ka hyrë në detyrim tek paditësja për 51 muaj, apo zbërthyer në vlera monetare shuma prej 55.40 €, për muaj (paga 421.20 € x 27% = 113.72 €, minus 58.32 €, përfitohet shuma prej 55.40€, x 51 muaj arrihet shuma prej 2,825.40€).

Nga të lartcekurat gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit jashtë seance, në kuptim të nenit 398 i LPK-së, sipas të cilit “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritot, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Duke qenë se ka lindur e drejta e paditësve për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për kompensim në pagë mbi bazën e inflacionit, të njëjtat janë legjitimuar që të kërkojnë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditëset e ka rolin e kreditorit kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditësve, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve t’ia kompensoj shumat si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadisë së paditësve në emër të kompensim për licencim-gradim për periudhën nga 22.11.2022 deri më 31.01.2023, gjithsej për 2 muaj, gjykata

ka gjetur se në këtë kohë nuk ka qenë në fuqi kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, pasi që e njëjta ka prodhuar efekt juridik nga data 18.04.2017 deri më 21.11.2022, prandaj edhe ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësve dhe atë: për paditësen e parë B. K. në shumën prej 110.80€, dhe për paditësen e dytë D. Sh. në shumën prej 110.80€, andaj gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, sepse e paditura nuk e konteston bazën e kërkesës, e as lartësinë e kërkesës së paditësve, me anë të përgjigjes në padi. Ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës, se për këtë objekt të kërkesë e paditura nuk ka planifikuar buxhet dhe nuk kanë vijë buxhetore për ta realizuar këtë kompensim, nuk është rrethanë e natyrës juridike që ndikon për te marr vendim ndryshe në këtë rast. Prandaj gjykata erdhi në përfundim se faktet në këtë rast, nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor dhe se pala e paditur është obliguar ta përmbush obligimin ndaj paditësve.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, e do të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë datë 28.03.2022.

Gjykata vendosi si në dispozitivin e III të këtij aktgjykimi, ashtu që e paditura të paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 186.00€, në kuptim të nenit 452 të LPK-së. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumë prej 156.00€ - sipas tarifës së OAK dhe taksa gjyqësore në shumë prej 30.00€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1106/2022, më 15.02.2024

Gjyqtari
Përparim Zeka

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.